



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
BASHKIA PËRMET
KËSHILLI BASHKIAK
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK

Datë 03/10/2025

PROCES VERBAL

Dëgjesë Publike për Paketën Fiskale 2026, Buxhetin e Bashkisë Përmet viti 2026, PBA 2026-2028

Vendi : Njësia Administrative Petran, Përmet

Ora : 10:00

Tema e konsultimit : Paketa Fiskale 2026, Buxheti 2026 dhe PBA 2026-2028

I mbajtur sot më datë 3 Tetor, pranë ambienteve të Njesisë Administrative Petran. Të pranishëm në këtë konsultim janë Kryetarja e Bashkisë znj. Alma Hoxha, nënkryetari i Bashkisë z. Florand Hasani, Kryetari i Komisionit të Ekonomisë në Këshillin Bashkiak, Përgjegjësi i Ujësjetllës Kanalizime Përmet, Kryetarët e Fshatrave dhe banorë të zonës.

Takimi u hap nga znj. Hoxha e cila si fillim përshëndeti të gjithë të pranishmit në këtë takim. Ajo në vazhdim foli rreth situatës aktuale në këtë njësi sipas inspektimeve të kryera dhe raportimeve nga Administratori i Njesisë. Më pas theksoi se këto takime janë mjaft të rëndësishme në hartimin e Paketës Fiskale, Buxhetit dhe PBA 2026-2028 për caktimin e prioriteteve për vitin e ardhshëm.

Gjithashtu znj. Hoxha u tregoi se shumë shpejt Bashkia do të sigurojë një mjet të ri për pastrim si dhe do të vazhdohet me vendosjen e koshave të rinj nëpër fshatra duke bërë që shërbimi i pastrimit të zgjerohet. Po ashtu u tha se do të realizohen disa ndërhyrje në rrugët e disa prej fshatrave me më shumë probleme.

Në përfundim të fjalës së saj, ajo ju drejtua të pranishmëve për të shprehur idetë dhe problematikat e zonave të tyre pasi zëri i tyre është i rëndësishëm në orientimin e punës së bashkisë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KËSHILLI BASHKIAK
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK

Sugjerimet e dala nga ky takim janë :

Fshati Petran

1. Ndërtimi i një ure të varur që lidh dy lagjet
2. Nevoja për të shtuar hapësirën e varrezave
3. Rrugët brenda fshatit me probleme të vogla

Fshati Gjinkar

1. Rruga e fshatit me probleme
2. Nevoja për të shtuar kosha të rinj në fshat

Fshati Qilarisht

1. Ndërhyrje në kanalin e vaditjes
2. Riparim i pompës së vaditjes
3. Nevoja për të shtuar kosha të rinj në fshat

Fshati Lëshicë

1. Probleme të vogla në disa prej kthesave të rrugës

Fshati Kaludh

1. Rikthimi i rezervuarit të vaditjes në gjendje pune
2. Problematika me ndricimin e fshatit
3. Problematika me ujin e pijshëm

Në fund të këtij takimi znj. Alma Hoxha i falenderoi për bashkëpunimin e mirë që ekziston ndër vite mes palëve si dhe u shpreh e gatshme për të diskutuar gjithmonë kur bëhët fjalë për të mirën e përbashkët të komunitetit.

Takimi u mbyll në orën **11:40**.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KËSHILLI BASHKIAK
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK**

Konceptoi:

Koordinatori i Konsultimit Publik

Albion Naska

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Denisa DURRO



Foto nga takimi:

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KËSHILLI BASHKIAK
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK

